

VENDIM
Nr.538, datë 4.12.1997

**PËR SHPALLJEN E UJËSJELLËSIT TË BOVILLËS SI OBJEKT I RËNDËSISHËM
SHTETËROR**

Në bazë të ligjit 7550, datë 20.1.1992 “Për policinë e objekteve”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ujësjellësi i Bovillës shpallet objekt i rëndësishëm shtetëror dhe merret në ruajtje nga Ministria e Brendshme me postë policie.

Objekti i ruajtjes do të jetë sheshi i impiantit të pastrimit, depoja e ujit në vendin e quajtur Kodra e Kuqe në fshatin Babrru, si dhe linja e ujësjellësit përgjatë rrugës së fshatit Zall-Herr deri në digën e Bovillës me gjatësi rreth 15 km.

2. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit të caktojë një fond prej 7.5 milionë lekësh në vit për 20 punonjës policie, i cili t’i kalojë Ministrisë së Brendshme për ruajtjen e objektit. Këto fonde të përballohen nga fondet e Buxhetit të Shtetit të akorduara për ujësjellësin e Bovillës si kosto lokale.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Brendshme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Fatos Nano